



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:259458

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05845561

KPPP.nr.1996/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit “Beghler Talo” SH.P.K., me numër unik identifikues 811866948, me seli në Prizren fshati Lubizhdë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “Beghler” L.L.C. me numër unik identifikues 801974081 me seli në Prizren, fshati Lubizhë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Ostrozubi, avokat nga Prizreni, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.351/23 të datës 27.11.2023 të Përbaruesit Privat Argjent Xheladini, me seli në Viti, jashtë seancës me datës 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Beghler” L.L.C. ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr.351/23 I datës 27.11.2023 i lejuar nga Përbaruesit Privat Argjent Xheladini, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Beghler Talo” SH.P.K. ka lëshuar Urdhrin Përbarimor P.nr.351/23 të datës 27.11.2023 me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm, Faturës me nr.254 të datës 13.12.2022 në shumë prej 154,370.96€, me të cilin ka detyruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën prej 154,370.96€, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e rënies në vonesë deri në pagesën definitive si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës përbarimore. Të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit të hapura në bankat komerciale dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare apo përmes përbarimit dhe sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me

shitjen të bëhet inkasimi i borxhit bashkë me shpenzimet e procedurës sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka ushtruar prapësim me të cilin ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor me arsyetimin se fatura në bazë të së cilës është lejuar përmbarimi nuk është faturë e shitjes, përkatësisht e njëjta nuk përmban elementet e faturës mbi shitjen e mallit, në të nuk janë të dhënat e kreditorit, debitorit si dhe nuk është paraqitur koha e përmbushjes së detyrimit, andaj debitori vlerëson se e njëjta në formën e paraqitur nuk përmban elementet e përmbarueshmërisë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të aprovoj prapësimin e debitorit në tërësi si të bazuar dhe të anuloj Urdhrin Përmbarimor P.nr.351/23 të datës 27.11.2023 me të cilin Përmbaruesi Privat Argjent Xheladini ka lejuar përmbarimin.

Kreditori brenda afatit ligjorë ka paraqitur përgjigje në prapësim me të cilën ka kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsyetimin se të njëjtat janë të pabazuara në dispozita ligjore dhe se qëllimi i vetëm i debitorit është zvarritja e procedurës. Tutje ka theksuar se pranimi i mallit sipas faturës konfirmohet përmes nënshkrimit të debitorit i cili pa vërejtje ka nënshkruar faturën e cila është objekt i kësaj procedure të përmbarimit. Sa i përket pretendimit mbi arritshmërinë e borxhit, përmes provave – komunikimeve elektronike kreditori thekson se vërtetohet se borxhi është arritur për pagesë pasi që i njëjti vazhdimisht është kërkuar nga kreditori. Ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e përgjigjes në prapësim. Në vlerë prej 550€ sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, kurse me neni 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti*

i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata vlerëson se Urdhri Përmbarimor P.nr.351/23 i datës 27.11.2023 bazohet në dokumente të besueshme, përkatësisht Fatura me nr.254 të datës 13.12.2022 në shumë prej 154,370.96€, e cila është e emërtuar si “daljet nga depoja doganore –RE EXPORT”, mirëpo sipas vlerësimit të gjykatës kjo faturë nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm për faktin se fatura në rastin konkret nuk përmban të dhënat e kreditorit dhe as të debitorit, pra ndonëse e njëjta është nënshkruar dhe vulosur në fund të saj nga debitori, në krye të këtij dokumenti nuk janë paraqitur të dhënat e debitorit. Po ashtu, në këtë dokument nuk është paraqitur as koha e përmbushjes së detyrimit.

Ndonëse si pjesë e shkresave të lëndës ishte edhe kontrata e lidhur midis kreditorit dhe debitorit, gjykata në procedurë përmbarimore i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj, meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është iniciuar kjo procedurë përmbarimore nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i përshtatshëm për përmbarim, në kuptim të nenit 71 të LPP-së, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1996/23, datë 21.06.2024

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.